



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR

# TERMA REFERENCE

MBIKQYRJE PUNIMESH PËR OBJEKTIN:

**“Ndërtimi i rrugës Palasë - Dhërmi”**

## TË PËRGJITHSHME

Me fonde të buxhetit të shtetit për vitin 2020 dhe ne vazhdim janë parashikuar punime në objektin: “Ndërtimi i rrugës Palasë - Dhërmi”.

Për këtë i kërkohet mbikqyrësit të punimeve të kësaj kontrate, të kryejë mbikqyrjen e punimeve të objektit, pas vlerësimit të projektit për fondin limit të llogaritur sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr 354, datë 11.05.2016 **“Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikqyrje dhe kolaudim”**.

## OBJEKTIVI KRYESOR

Mbikqyrësi i punimeve për këtë objekt e ka për qëllim që pas kryerjes nga ana e tij të vlerësimit tekniko -ekonomik të projekt zbatimit, të kontrollojë dhe të ndjekë mbarëvajtjen e gjithë procesit të zbatimit të punimeve në përputhje me projektin, kushtet teknike të zbatimit, specifikimet teknike si dhe destinacionin e objektit, duke patur parasysh afatin kohor të përcaktuar për kryerjen e punimeve, dhe anën ekonomike të këtij objekti.

## TË DHËNA MBI PROJEKTIN

Ky projekt e trajton aksin rruga Palasë – Dhërmi si vazhdim të aksit rrugor Orlikum- Himarë në aspektin e parametrave gjeometrik, sinjalistikës dhe sigurisë rrugore.

Rruga Palasë – Dhërmi është rrugë nationale dhe aksi rrugor me gjatësi 4.45 km është tërësisht i ri.

Ky projekt fillon me lokacionin e fundit të lotit Tynelit Llogara, ndërprerja e rrugës me rrugën zbritëse Rrugët e Bardha Palasë, vazhdon më tej duke i bërë Bypass zonave të mbrojtura të fshatrave Palasë, Dhërmi e duke u lidhur me një nyje të rëndësishme me dalje në rrugën e Perivolos për zonën e Drimadhës, e më pas vjen nyja e fundit në rrugën e kampit Dhërmi. Kështu lihet e mundur lidhja në perspektive me Himarën.

Gjatë projektimit janë konsideruar kuotat e daljes së mundshme të tunelit dhe të rrugës dalëse të tij deri në intersektimin në nyjen e Palasës.

Lokacionet e rëndësishme në zonë, për tu lidhur me rrugën janë: daljet e nevojshme për zonën Drimadhes në kryqëzim me rrugën Perivolo; lidhja me lokacionet turistike; rrugën për aksesimin e vilës qeveritare nëpërmjet rrugës së Perivolos; rakordimin e rruges së re me rrugën e kampit Dhërmi.

Gjatë gjithë aksit rruga Palasë – Dhërmi është paraqitur nevoja e zgjidhjes së segmenteve të caktuara duke parashikuar vepra te ndryshme arti: vepra arti të vogla si mure mbajtës/pritës dhe rreth 100m terramesh, tombino rrethore dhe box me dimensione te ndryshme, nënkalim box 8\*4.6.

Vepra arti të mëdha është parashikuar Ura e Palasës me gjatësi 108 m me tre hapesira nga 36m.

Është parashikuar sinjalistika horizontale/ vertikale dhe barrierat metalike.



Parametrat gjeometrike që plotëson projektin për rrugën kryesore janë:

- |                                 |                           |
|---------------------------------|---------------------------|
| • Kategoria e Rrugës            | - C 2                     |
| • Gjerësia e Rrugës             | - 11.5 m                  |
| • Gjerësia e Karexhatës         | - 2x3.5 m                 |
| • Bankina të asfaltuara         | - 2x1.25 m                |
| • Bankina të pa asfaltuara      | - 2x 1 m                  |
| • Shpejtësia e Projektimit      | - 80km/ore (zona fushore) |
| • Pjerrësia Gjatësore maksimale | - 7%                      |

Shtresat rrugore në rrugën kryesore:

- |                         |       |
|-------------------------|-------|
| - Asfalt                | 4 cm  |
| - Binder                | 5 cm  |
| - Konglomerat bituminoz | 10 cm |
| - Stabilizant           | 15 cm |
| - Çakëll                | 25 cm |

Parametrat gjeometrike që plotëson projektin për rrugën dytësore janë:

- |                         |            |
|-------------------------|------------|
| • Kategoria e Rrugës    | - F 2      |
| • Gjerësia e Rrugës     | - 8.5 m    |
| • Gjerësia e Karexhatës | - 2x3.25 m |
| • Bankina të asfaltuara | - 2x1 m    |

Shtresat rrugore në rrugët dytësore:

- |               |       |
|---------------|-------|
| - Asfalt      | 4 cm  |
| - Binder      | 6 cm  |
| - Stabilizant | 15 cm |

## DETYRAT, PËRGJEGJËSITË DHE TË DREJTAT E MBIKQYRËSIT

Në realizimin e objektivave për zbatimin e punimeve të objektit: “**Ndërtimi i rrugës Palasë – Dhërmi**” mbikqyrësi menjëherë pas lidhjes së kontratës duhet:

- Të njihet në detaj me projekt zbatimin dhe specifikimet teknike të objektit,
- Të hartojë programin e kontrollit për zbatimin e projektit dhe cilësisë së punimeve në bazë të standardeve të përcaktuara me ligj.
- Të mbikqyrë Kontratën e zbatimit të punimeve në emër të Autoritetit Rrugor Shqiptar dhe të kryejë të gjitha detyrimet e besuara atij sipas Kontratës së nënshkruar dhe sipas Ligjit Nr. 8402 dt 10.09.1998, UKM Nr.3 dt.15-02 2001, UKM Nr.1 dt. 22.02.2005, UKM Nr 2 dt.13.5.2005, U.K.M nr.1 dt. 16.06.2011, VKM nr. 628 dt. 15.07.2015. Rregullat teknike të ndërtimit dhe projektimit të rrugëve“, VKM nr. 111 dt. 10.02.2016.
- Të bëjë verifikimin e të gjithë dokumentacionit përkatës, të licencave, të autorizimeve dhe të lejeve, të cilat sipas dispozitave në fuqi duhet të merren para fillimit të punimeve.
- Të bëjë verifikimin e sheshit të ndërtimit nëse është i lirë dhe i gatshëm për të filluar punimet.



- Të njihet mirë me kontratën e sipërmarrësit dhe të gjitha akteve administrative që lidhen me të si dhe të njohë të gjitha ndryshimet e mundshme të kësaj kontrate me kalimin e kohës.
- Të kontrollojë vendosjen e tabelës së identifikimit të objektit
- Të marë masat e duhura për sigurinë e objektit duke kontrolluar vendosjen në objekt të tabelave përkatëse sinjalizuese, treguese e të sigurisë, shiritave, fenerëve etj.
- Pas verifikimit të dokumentacionit duhet të dorëzojë pranë ARrSh-së të gjithë dokumentacionin si dhe shkresën për fillimin e punimeve ku përfshihen:
- Stafi i Sipërmarrësit
- Makineritë që do përdoren për ndërtimin e objektit.
- Para fillimit të punimeve verifikon të gjitha pajisjet dhe makineritë e sipërmarrësit, për të parë nëse ato i përgjigjen kushteve të kontratës së nënshkruar.
- Të kontrolloj zbatimin e projektit duke u bazuar në projekt zbatimin dhe specifikimet teknike dhe të propozojë modifikimet, plotësimet dhe mospërputhjet nëse ka dhe ti rekomandojë ARrSh-së zgjidhjet konkrete.
- Të ndjekë në mënyrë të vazhdueshme e të kualifikuar të gjitha proceset e punimeve dhe dokumentacioneve që duhen të mbahen gjatë zbatimit të punimeve, miratimin e analizave të veçanta duke dhënë udhëzime porosi e urdhëra për zbatimin me përpikmëri e në kohë të projektit, të kushteve teknike të projektimit dhe zbatimit, të dispozitave përkatëse të kontratave.
- Të kontrollojë në mënyrë korrekte dhe të vazhdueshme piketimin e objektit.
- Të kontrollojë çdo material që vendoset në vepër, mënyrën e vendosjes së tij dhe cilësinë e tij.
- Për çdo punim të maskuar të bëjë fotografimin ose rregjistrimin e tij dhe të mbajë proces – verbal të firmosur prej tij dhe sipërmarrësit.
- Në çdo fund dite pune të kontrollojë ditarin e punimeve dhe të firmosë atë.
- Të kontrollojë librin e masave i cili vërteton volumin e punimeve dhe ta miratojë atë.
- Të kontrollojë certifikatat e cilësisë së materialeve dhe të jap miratimin për vendosjen në objektin e tyre.
- Gjatë zbatimit të projektit, i jep instruksione me shkrim sipërmarrësit, sa herë që e sheh të nevojshme dhe sipërmarrësi është i detyruar t'i zbatojë ato. Ky i fundit ka të drejtë të bëjë me shkrim vërejtjet e tij lidhur me instruksionet dhe urdhërat e marrë.
- Për çdo rast, që gjatë zbatimit të punimeve lind nevoja e ndryshimeve në Projektin dhe Preventivin e parashikuar, Mbikqyrësi i Punimeve duhet t'i paraqesë ARrSh-së një relacion të plotë teknik (shoqëruar me skicat përkatëse) ku argumentohet ndryshimi. Ndryshimi në objekt (zbatimi i punimeve) do të bëhet vetëm pas miratimit nga ARrSh -ja.
- Në çdo fund muaji mbikqyrësi ka për detyrë të paraqesë pranë ARrSh-së raportet mujore të punimeve. Në këtë raport duhet të jepet një tabullo e qartë e avancimit të punimeve dhe të pagesave të kryera. Realizimi i punimeve në vleste dhe %, afati kohor realizimi i financimit.

#### ***Mbikqyrësi duhet :***

A.- Të paraqesë pranë ARrSh-së stafin e tij mbikqyrës në përbërje të së cilit duhet të ketë:

1. ***Drejtuesin e projektit*** që duhet të jetë inxhinier ndertimi me eksperiencë pune në mbikqyrje i cili mban përgjegjësi për zbatimin e projektit sipas kushteve teknike të zbatimit, miratimin e volumeve të punimeve, çertifikatën e pagesës, mbajtjen, kontrollin dhe miratimin e gjithë dokumentacionit, miratimin e ndryshimeve të volumeve, korespondencën me ARrSh.



2. *Mbikqyresin për strukturat* që duhet të jetë inxhinier strukturist me eksperiencë pune në këtë fushë.
3. *Mbikqyrësin e materialeteve* që duhet të jetë inxhinier ndërtimi me eksperiencë pune në këtë fushë i cili miraton materialet dhe cilësinë e tyre dhe ndjek e miraton cilësinë e punimeve.
4. *Mbikqyrësin për punimet topografike* që duhet të jetë inxhinier topograf me eksperiencë pune i cili kontrollon dhe miraton volumet, pikimet dhe kuotëzimin e objektit.
5. *Mbikqyrësin (gjeolog), duhet të jetë inxhinier gjeolog* me eksperiencë pune i cili kontrollon punimet gjatë gërmimit .
6. *Mbikqyrësin për njedisin, duhet të jetë inxhinier mjedisi* me eksperiencë pune i cili kontrollon punimet e zbatimit të projektit.
7. *Mbikqyrësin per punimet hidroteknike, duhet te jete inxhinier hidroteknik* me eksperience pune i cili kontrollon punimet e zbatimit te projektit.
8. *Mbikqyrësin për sinjalistikën dhe sigurinë rrugore, duhet të jetë inxhinier* me linçensën përkatëse.
9. *Mbikqyrës për punimet elektrike,* të jetë inxhinier elektrik me eksperiencë pune i cili kontrollon punimet e zbatimit të projektit.

**B.-** Në bazë të volumit të punimeve dhe vleftës së kontratës drejtuesi i punimeve duhet të jetë rezident në objekt dhe stafi tjetër mbikqyrës mund të jetë rezident çdo ditë në objekt ose me kohë të pjesshme në funksion të specifikave të punës.

**C.-** Mbikqyrësi i punimeve dhe stafi i tij kontrakton me ARrSh-në, duke përcaktuar detyrimet e ndërsjellta, kushtet e punës, shpërblimin dhe probleme të tjera, etj.

**D.-** Mbikqyrësi vihet në dijeni nga ARrSh-ja për nënkontratorët e mundshëm që zgjedh sipërmarrësi në përputhje me kontraten e nënshkruar.

**E.-** Mbikqyrësi në fillim të punimeve në objekt merr kontakt me organet qeverisëse në juridikcionin e të cilit ndodhet zona ku kryhet ky objekt dhe informon për personat kryesor, përgjegjës për ndërtimin e këtij objekti në përputhje me nenin 9, të ligjit Nr.8402, dt 10.09.1998.

### Raportimi

IV/b- Gjatë zbatimit të punimeve Mbikqyrësi i punimeve duhet të dorëzojë çdo muaj Raportet Mujore të cilat duhet të përbajnë:

- *Hyrje*
- *Informacion i përgjithshëm*
  - *Të përgjithshme*
  - *Qëllimi i punimeve*
  - *Mbikqyrja e punimeve ndërtimore*
- *Personeli i siguruar nga Mbikqyrësi*
  - *Stafi i nevojshem në perputhje me kontraten e zbatimit të punimeve.*
  - *Stafi aktual*
  - *Kohëqëndrimi në objekt për secilin.*
- *Raportimi*
- *Kohëzgjatja e shërbimit të Mbikqyrjes*
- *Përshkrimi i Projektit*
  - *Shtresat Rrugore*
  - *Veprat e Artit etj.*



- *Organizimi i Sipërmarrësit*
  - *Sipërmarrësi*
  - *Staf i prezent*
  - *Mjete dhe makineri*
  - *Kohëqëndrimi në objekt*
- *Progresi Mujor*
- *Përshkrim të Punimeve që janë kryer gjatë muajit (sipas zërave dhe piketave)*
- *Fotografi të proceseve të punimeve të kryera*
- *Fotografi të punimeve të maskuara për çdo punim të padukshëm.*
- *Grafiku i ecurisë së punimeve*
  - a - *Të aprovuara*
  - b - *Të kryera*
- *Volumet Progresive të Punimeve Mujore*
  - a - *Punimet e aprovuara*
  - b - *Çertifikatat e cilesisë dhe Provat Laboratorike*
  - c - *Libreza e Masave*
  - d - *Punimet e kryera por të pa aprovuara*
  - e - *Situacionet mujore*
  - f - *Matjet topografike*
- *Korrespondecia*
  - a - *Proces-Verbale*
  - b - *Urdhra, Udhëzime, Njoftime*
  - c - *Ndryshime në Projekt dhe Preventiv nëse ka (të aprovuara nga ARrSh-ja)*
- *Moti (kalendarik)*
- *Problemet që kanë dalë*
  - a - *Teknike*
  - b - *Sociale*
- *Raport mbi sigurinë në kantier*
- *Masat për ruajtjen e mjedisit*
- *Konkluzione*

Shënim: Raporti Mujor dhe dokumentat duhet të paraqiten në gjuhën shqipe, në pesë kopje dhe tre kopje të dorëzohen në ARrSh pranë Drejtorisë së Ndërtimit dhe Mirëmbajtjes.

Raporti Mujor do t'i dorëzohet ARrSh-së brenda datës së caktuar në kontratë.

Konslumenti do të mbajë kontakte të vazhdueshme me ARrSh (Drejtorinë e Ndërtimit dhe Mirëmbajtjes dhe Drejtorinë e Planifikimit Strategjik dhe Operacioneve ) dhe do t'i përgjigjet të gjitha kërkesave të saj.

## **MBIKQYRËSI MBAN PËRGJEGJËSI TË PLOTË**

Në fillim të punimeve mbikqyrësi mban dhe ka përgjegjësi për dokumentacionin e mëposhtëm:

- Lejën origjinale të ndërtimit.
- Projekt zbatimin e firmosur nga projektuesi dhe investitori së bashku me specifikit teknike
- Dokumentacionin topografik dhe gjeologo-inxhinierik të bazamentit ku do të kryhen punimet
- Realizimin e punimeve të objekteve sipas projektit kushteve teknike të zbatimit në fuqi dhe



specifikkimeve teknike

- Saktësinë, vërtetësinë e dokumenteve, volumet dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit.
- Për realizimin pikë për pikë të kontratës së nënshkruar midis Sipërmarrësit dhe A.Rr.Sh-së e të gjitha fazave të zbatimit të punimeve, respektimit të afatit të dorëzimit si dhe të kostos së objektit.
- Asnjë punim nuk do të mbulohet, maskohet apo betonohet pa miratimin e mbikqyrësit. Sipërmarrësi duhet të njoftojë mbikqyrësin kur është gati për t'u ekzaminuar prej tij.
- Ruajtjen e të gjithë dokumentacionit dhe korespondencën me Drejtorinë e Ndërtimit dhe Mirëmbajtjes, urdhrat e ndryshme që ai ka dhënë gjatë zbatimit të kontratës, kundërshtitë dhe kontradiktat e lindura gjatë punës, ndërprerjet e punimeve dhe shkaqet që i kanë diktuar këto ndërprerje, relacionet teknike të kërkuaara ose të paraqitura gjatë zbatimit si dhe të gjitha rrethanat e nevojshme për të dhënë kuadrin e plotë të të gjithë fazave të zbatimit të punimeve.
- Për dorëzimin e gjithë dokumentacionit që disponon në rast se gjatë zbatimit të kontratës s'kemi ndryshim të mbikqyrësit, i gjithë dokumentacioni dorëzohet me proces verbal ku shënohen dhe shkaqet e këtij ndërrimi.

#### **MBIKQYRËSI KA TË DREJTË:**

- Të kërkojë largimin nga puna të drejtuesit të kantierit ose të puntorëve të veçantë për mosbindje, paaftësi ose pakujdesi të rëndë.
- Të mos pranojë drejtues teknik, manovrator, punëtor n.q.s këta nuk plotësojnë kushtet për të kryer detyrën e caktuar.
- Të pezullojë punimet kur sheh se në objekt nuk janë marrë masat e duhura për të siguruar punimet dhe trafikun.
- Të mos lejojë vendosjen në vepër të materialeve që nuk plotësojnë kushtet e cilesisë dhe ti zëvendësojë ato me materiale të tjera nga sipërmarrësi me shpenzimet e tij.
- Të kërkojë certifikatat e cilësisë së pajisjeve që kryejnë testet e materialeve.
- Të kërkojë dhe të jetë prezent në kryerjen e provave të materialeve, për të verifikuar cilesinë e tyre. Shpenzimet për këto prova janë në ngarkim të sipërmarrësit.
- Të kërkojë për të gjitha makineritë që punojnë në vepër dokumentacionet teknike për të siguruar një ecuri punimesh të sigurta dhe cilësore.
- Të mos lejojë përdorimin e makinerive dhe pajisjeve të ndryshme n.q.s ato janë jashtë kushteve teknike.
- Në rast se materialet dhe pajisjet e përdorura nuk miratohen nga mbikqyrësi këto duhet të dokumentohen me procesverbalet e analizave të provave së bashku me aktin teknik, ku të argumentohen shmangjet e palejuara referuar standarteve të përcaktuara në specifikimet teknike të projektin e zbatimit.
- Kur Mbikqyrësi i Punimeve mendon se ka dëmtime në konstruksion kërkon të bëhen verifikimet përkatëse. Kur verifikimet i japin të drejtë mbikqyrësit, shpenzimet janë në ngarkim të sipërmarrësit. Në rast të kundërt, sipërmarrësi ka të drejtë të kërkojë shlyerjen e shpenzimeve në rrugë kontraktuale.
- Mbikqyrësi i punimeve urdhëron Sipërmarrësin të prishë dhe të ribëjë me shpenzimet e tij, punime të bëra jo me cilësinë e parashikuar në Projekt dhe Specifikimet Teknike.
- Mbikqyrësi i punimeve ka të drejtë të pezullojë përkohësish punimet, për ekzekutim teknik të gabuar ose paaftësi teknike zbatimi, për çdo rast me miratimin e ARrSh-së për aq kohë sa ai e konsideron të arsyeshme. Në këtë rast sipas shkakut, mbikqyrësi së bashku me ARrSh-në dhe sipërmarrësin përcaktojnë zgjatjen ose jo të afatit dhe ndryshimin e shpenzimeve.
- Të kontrollojë dhe autorizojë përdorimin e fondit rezervë të preventivuar dhe i raporton



- periodikisht ARrSh-së për gjëndjen e tij.
- Për çdo ndryshim të mundshëm mbikqyrësi i punimeve vihet në dijeni për të ndjekur zbatimin e ndryshimeve në fjalë.

#### **Në përfundim të punimeve mbikqyrësi:**

- Merr me shkrim njoftimin për përfundimin e punimeve dhe vërteton në proces verbal datën e përfundimit të tyre sipas projektit, të ndryshimeve të urdhëruara e të kushteve të kontratës dhe brenda 30 ditëve merr prej sipërmarrësit dokumentacionin përkatës .
- Duke u mbështetur në Ligjin 8402 dt 10.09.1998 UKM Nr 2 datë 13.5.2005 dhe UKM Nr 3 date 15.02.2001, dorëzon pranë ARrSh-së (Drejtorisë së Ndërtimit dhe Mirëmbajtjes, Sektorit të Sigurimit Cilësisë) të gjithë dokumentacionin përkatës për të cilin mban përgjegjësi të plotë në plotësimin, saktësinë, vërtetësinë e tij.

#### **Ky dokumentacion duhet të përmbajë :**

- Proses verbal i dorëzimit të sheshit të ndërtimit.
- Proses verbal për fillimin e punimeve.
- Kontratën e sipërmarrësit
- Kontratën e mbikqyrjes
- Projekt organizimi i punimeve.
- Projektin
- Projektin e ndryshuar (nëse ka) shoqëruar me korespondencën skicat përkatëse dhe miratimet e nevojshme.
- Preventivin fitues
- Preventivin e ndryshuar (nëse ka zërat të rindërtimit të punimeve negocimin e tyre).
- Grafiku i punimeve
- Specifikimet teknike
- Axhornimi para fillimit të punimeve dhe piketimi.
- Dokumentacioni topografik dhe gjeologo inxhinjerik për (ndërtim rrëshqitje).
- Dokumentacioni fotografik apo video regjistruesi për punimet e padukshme.
- Proses-verbalet e çdo punimi të maskuar të firmosur nga drejtuesi teknik dhe mbikqyrësi të shoqëruar me fotografë.
- Ditari i objektit ku të pasqyrohen dhe ndryshimet e urdhëruara nga mbikqyrësi.
- Libreza e masave.
- Shkresën e mbikqyrësit për investitorin ku raporton përdorimin e fondit rezerve i shoqëruar me dokumentacionin përkatës.
- Proses verbal i përdorimit të fondit rezervë të firmosur nga Sipërmarrësi (drejtuesi teknik) dhe mbikqyrësi
- Preventivi i fondit rezervë të firmosur nga sipërmarrësi (drejtuesi teknik) dhe mbikqyrësi
- Situacion i fondit rezerve të firmosur nga Sipërmarrësi (drejtuesi teknik) dhe mbikqyrësi
- Çertifikatat e cilësisë së materialeve.
- Miratim i materialeve të perdonura nga mbikqyrësi.
- Situacionet pjesore dhe atë përfundimtar.
- Regjistri i kontabilitetit.
- Deklarata teknike e sipërmarrësit e firmosur nga sipërmarrësi dhe drejtuesi teknik.
- Njoftimi i sipërmarrësit për përfundimin e punimeve.



- Proces verbal i përfundimit të punimeve të firmosur nga sipërmarrësi dhe mbikqyrësi sëbashku me matjet faktike të objektit të ndërtuar.
- Relacionin përfundimtar i mbikqyrësit

I gjithë dokumentacioni duhet të ketë miratimin e tij. Ky dokumentacion është në 3 (tre) kopje. Një kopje e të gjithë dokumentacionit dorëzohet pranë grupit të kolaudimit që ngrihet me urdhër nga ARrSh -ja brënda 30 ditëve nga përfundimi i objektit. Të gjithë dokumentat që i dorëzohen grupit të kolaudimit pranë ARrSh-së duhet të jenë origjinalë.

Mbikqyrësi i Punimeve merr pjesë në Kolaudimin e objektit dhe i përgjigjet Grupit të Kolaudimit për të gjithë dokumentacionin e nevojshëm gjatë kolaudimit të objektit dhe nënshkruan aktin përkatës. Pas përfundimit të kolaudimit mbikqyrësi i punimeve mbështetur në kontratën dhe në dokumentacionin tjeter, përcakton vlerën përfundimtare të objektit e cila i bëhet e ditur sipërmarrësit dhe i jepet për të likuiduar ARrSh-së.

### **KOHËZGJATJA E SHËRBIMIT TË MBIKQYRJES**

Do të jetë për gjithë periudhen e zbatimit të punimeve.

### **TË DREJTAT E A.RR.SH-së.**

ARrSh-ja ka të drejtë të kërkojë largimin e mbikqyrësit kur vërteton mangësi serioze në veprimtarinë e tij si:

- Mangësi në plotësimin e detyrave të përcaktuara.
- Ndërprerje e pa arsyeshme e punimeve dhe zgjatje e theksuar e tyre.
- Mangësi kontrolli në kosto e kontabilitet. Tolerim i materialeve me vlera mbi ato të preventivuara, tolerim të materialeve jashtë cilësisë së kërkuar, tolerim të punimeve jo me cilësinë e kërkuar, tolerim të pajisjeve jashtë kushteve teknike.

Kur vërehen shkelje të rënda të dispozitave ligjore, ARrSh-ja ka të drejtë të urdhërojë mbikqyrësin e punimeve për ndërprerjen e punës deri në marrjen e masave përkatëse për normalizimin e gjendjes. Kur shkeljet e dispozitave ligjore mund të përbëjnë kundërvajtje administrative, vendosen sanksione në bazë të neneve 15 dhe 16 të kreut III të ligjit Nr 8402 dt 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit"

### **MËNYRA E DHËNIES SË OFERTËS**

Oferta jepet në vlefte totale e zbërthyer në shpenzime për muaj - njeri (sipas preventivit bashkangjitur) dhe shpenzime të tjera të nevojshme për t'u kryer.

### **MËNYRA E PAGESËS**

Pagesa do të bëhet mujore, në bazë të % së realizimit të punimeve të zbatimit e zbërthyer sipas shpenzimeve muaj- njeri.



**PREVENTIV**

**MBIKQYRJE PUNIMESH**

**Objekti : Mbikqyrje punimesh për objektin : “Ndërtimi i rrugës Palasë – Dhërmi”**

**Vlera e kontratës**

**Ilekë(me TVSH)**

<b>Kodi</b>	<b>Emërtimi</b>	<b>Njësia</b>	<b>SHPENZIMET</b>		
			<b>Sasia</b>	<b>Çmimi</b>	<b>Vlefta</b>
<b>Stafi</b>					
Drejtori projekti – inxh. Ndërtimi/transport	Staf /muaj	(100%)			
Inxhinier Strukturist	Staf /muaj	(50%)			
Inxhinier materiali	Staf /muaj	(80%)			
Inxhijnier topograf	Staf /muaj	(100%)			
Inxhinier hidroteknik	Staf /muaj	(50 % )			
Inxhinier gjeolog	Staf /muaj	(60 % )			
Inxhinier mjeti	Staf /muaj	(40 % )			
Inxhinier sigurie rrugore	Staf /muaj	(20%)			
Inxhinier elektrik	Staf /muaj	(20%)			
<b>Shuma 1</b>					
<b>Shpenzime</b>					
Shpenzime të ndryshme	Lump sum				
Paisje, materiale etj	Lump sum				
<b>Shuma 2</b>					
<b>TOTALI</b>					

**MBIKQYRËSI I PUNIMEVE**

“ \_\_\_\_\_ ”



Autoriteti Rrugor Shqiptar

Rruja Sami Frashëri, Nr.33, Tiranë. Email:info@arrsh.gov.al Tel: 04 222 3600

**LLOGARITJA E FONDIT LIMIT PËR SHËRBIMIN MBIKQYRJE**  
**"SUPERVIZION PUNIMESH NDERTIM RRUGA PALASE DHERMI "**

**LLOGARITJA E FONDIT LIMIT PER SHERBIMIN SIPAS VKM-SË 354 DATË 11.05.2016**

<b>VLERA MAKSIMALE E MBIKQYRJES PA TVSH</b>	lekë	<b>12,057,435.49</b>
<b>VLERA MAKSIMALE E MBIKQYRJES ME TVSH</b>	lekë	<b>14,468,922.59</b>
<b>VLERA KOSTOS SE LLOGARITUR TOTAL ME TVSH</b>	lekë	<b>1,943,381,886.08</b>
<b>VLERA E KOSTOS LLOGARITUR PA TVSH</b>	lekë	<b>1,619,484,905.07</b>

**VLERA E KOSTOS SË LLOGARITSHME ËSHTE NDARË SI VIJON**

**A.1 TARIFA E SHËRBIMIT TË MBIKQYRJES SË PUNIMEVE VEPRAVE INXHINIERIKE**

KLASIFIKIMI I GRUPIT NË BAZË TË SHUMËS SË PIKAVE TË VLERËSIMIT,DUKE JU

**GRUPI IV**

REFERUAR NENIT 38,PIKA 2,3,4 :

<b>VLERA E TARIFËS MAXIMALE</b>			<b>MAX</b>
<b>MBIKQYRJA PËR</b> <b>PUNIME INXHINIERIKE</b>	<b>FAZA VIII</b>	<b>20%</b>	<b>4,683,929.47</b>

**A.2 TARIFA E MBIKQYRJES PËR STRUKTURAT E TRANSPORTIT**

KLASIFIKIMI I GRUPIT NË BAZË TË SHUMËS SË PIKAVE TË VLERËSIMIT,DUKE JU

**GRUPI IV**

REFERUAR NENIT 44,PIKA 2,3,4 :

<b>VLERA E TARIFËS MAXIMALE</b>			<b>MAX</b>
<b>MBIKQYRJE PËR PUNIME</b> <b>TRANSPORTI</b>	<b>FAZA VIII</b>	<b>20%</b>	<b>6,168,333.22</b>

**A.1.1 TARIFA E SHËRBIMIT TOPOGRAFIK TË MBIKQYRJES TË PUNIMEVE VEPRAVE INXHINIERIKE**

PLANI I TARIFIMIT,DUKE JU REFERUAR NENIT 68,PIKA 2: 60 % E KOSTOVE TE VEPRAVE

**GRUPI IV**

INXHINIERIKE

<b>VLERA E TARIFËS MAXIMALE</b>			<b>MAX</b>
<b>MBIKQYRJA PËR</b> <b>TOPOGRAFINË PUNIME</b> <b>INXHINIERIKE</b>	<b>FAZA VIII</b>	<b>18%</b>	<b>271,845.49</b>

**A.2.2 TARIFA E SHËRBIMIT TOPOGRAFIK TË MBIKQYRJES TË PUNIMEVE TË TRANSPORTIT**

PLANI I TARIFIMIT,DUKE JU REFERUAR NENIT 68,PIKA 2: 80 % E KOSTOVE TE

**GRUPI IV**

PUNIMEVE TË TRANSPORTIT

<b>VLERA E TARIFËS MAXIMALE</b>			<b>MAX</b>
<b>MBIKQYRJA PËR</b> <b>TOPGRAFINE PUNIME</b> <b>TRANSPORTI</b>	<b>FAZA VIII</b>	<b>18%</b>	<b>933,327.31</b>

			MAKSIMUM
<b>GRUPI IV</b>	<b>STRUKTURA</b>		38.8%
<b>GRUPI IV</b>	<b>TRANSPORT</b>		51.2%
<b>GRUPI IV</b>	<b>TOPOGRAFI STRUKTURA</b>		2.3%
<b>GRUPI IV</b>	<b>TOPOGRAFI TRANSPORT</b>		7.7%
	<b>TOTALI</b>		<b>100.0%</b>
			<b>12,057,435.49</b>